

VENDIM
Nr. 178, datë 26.3.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 707, DATË 25.8.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 400 KV,
TIRANË-PODGORICË, QARKU TIRANË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pikat 3 dhe 4 të vendimit nr. 707, datë 25.8.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3.Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe totale prej 9374.45 (nëntë mijë e treqind e shtatëdhjetë e katër pikë dyzet e pesë) m², tokë bujqësore, shtëpi, arë dhe ullishta, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 139 117 832 (njëqind e tridhjetë e nëntë milionë e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy) lekësh.

4. Fondi prej 139 117 832 (njëqind e tridhjetë e nëntë milionë e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy) lekësh të përballohet nga fondet e OST, sh.a.-së.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama